

KOSOVO



**KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE**

Prishtinë, 10.01.2025

**Shpallje Publike për Auditor të Jashtëm (Cikli Olimpik 2025-2028)
Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK)**

Komiteti Olimpik i Kosovës ka statusin e personit juridik, është e regjistruar si organizatë joqeveritare pranë MAP si dhe i takon Lëvizjes Olimpike duke u angazhuar që të respektojë dispozitat e Kartës Olimpike, andaj si e tillë lidh kontrata të ndryshme, punëson si dhe angazhon persona juridik dhe fizik për ofrimin e shërbimeve të ndryshme profesionale.

Përshkrimi i shërbimit:

Shërbimi përfshin auditimin e jashtëm të pasqyrave financiare dhe përputhshmërisë ligjore të KOK për periudhën 01 janar 2025 – 31 dhjetor 2028. Kompania e përzgjedhur do të jetë përgjegjëse për ofrimin e një raporti të pavarur dhe profesional mbi veprimtaritë financiare dhe ligjore të KOK gjatë këtij cikli Olimpik.

Kriteret e aplikimit:

1. Të jenë kompani të licencuara për auditim financiar dhe ligjor nga KKRF - Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar nga Ministria e Financave, Punës dhe Trasnfereve;
2. Të kenë përvojë të dëshmuar në ofrimin e shërbimeve të auditimit për organizata të ngjashme.
3. Të ofrojnë një ekip ekspertësh me kualifikime përkatëse dhe përvojë në fushën e auditimit.
4. Të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:
 - o Dëshminë e licencës;
 - o Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
 - o CV-të e ekspertëve që do të angazhohen;
 - o Raporte të auditimeve të mëparshme të kryera për organizata të ngjashme;
 - o Ofertën financiare të detajuar;

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Ofertat e detajuara, së bashku me dokumentet mbështetëse, duhet të dërgohen në adresën zyrtare të emailit të KOK: finance@noc-kosovo.org, më së largu deri më datën **24 janar 2025**, ora **16:00**.

Vlerësimi i ofertave:

Bordi Ekzekutiv i KOK do të shqyrtojë dhe vlerësoi ofertat e pranuar bazuar në këto kritere:

- Cilësia dhe përvoja e kompanisë.
- Ekspertiza e ekipit auditues.
- Çmimi dhe kostoja e shërbimit.

Informacione shtesë:

- Vetëm ofertat e dorëzuara brenda afatit të përcaktuar do të shqyrtohen.
- Përzgjedhja do të bëhet brenda një afati të arsyeshëm pas përfundimit të periudhës së aplikimit.
- KOK rezervon të drejtën për të kontaktuar vetëm kompanitë e përzgjedhura për fazën përfundimtare të negociatave.

Për çdo paqartësi apo pyetje shtesë, ju lutemi kontaktoni në adresën e emailit: finance@noc-kosovo.org.

Me respekt,

Komiteti Olimpik i Kosovës